

**Adresa:** Ish Ndërtesa e Gërmisë
10000, Prishtina
Republika e Kosovës

**Tel.:** 038-200-28-507

Zyrtarja për Barazi Gjinore / Ministria e Infrastrukturës

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
*QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT*

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

# STOP
## DHUNËS NDAJ GRUAS

2016

Në sesionin e 54-të të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të mbajtur në dhjetor të vitit 1999, është miratuar Rezoluta 54/134, ku 25 nëntori është shpallur ditë ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj gruas, që simbolizohet me **“Kordelen e bardhë”.**




Fushata **”16 Ditët e Aktivizmit”** kundër dhunës ndaj gruas, është një traditë që nisi në vitin 1991 nga Instituti i parë i Lidershipit Global të Grave. Ajo fillon me **25 Nëntor** “Dita Ndërkombëtare Kundër Dhunës ndaj Gruas” dhe vazhdon deri me **10 Dhjetor** “Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut”, duke lidhur simbolikisht këto dy data në përforcim të mesazhit se dhuna ndaj gruas është shkelje e të drejtave të njeriut.

**Familje pa dhunë – shoqëri në PAQE!**

Një kapital me vete **“të drejtat e gruas”**

**Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

**Neni 24.1**

Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

**Ligj për Mbrojtje nga Dhuna në Familje nr. 03/L-182**

**Neni 1.1**

Ky ligj ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore, të pjesëtarëve të familjes, që janë viktima të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.

**Ligji për Barazi Gjinore Nr. 05/L - 020**

**Neni 3**

**1.1. Barazia gjinore** - është ushtrimi i plotë dhe i barabartë i femrave dhe meshkujve i të drejtave të tyre të njeriut. Është mosprania e diskriminimit në bazë gjinore në mundësitë, ndarjen e burimeve apo përfitimeve si dhe qajsen në shërbime.